



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
GJIROKASTËR
BORDI I ADMINISTRIMIT

V E N D I M

NR. 09 , datë 07.02.2020

MIRATIMI I HAPJES SË PROGRAMEVE TË REJA

NË UNIVERSITETIN "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL-të në Republikën e Shqipërisë", neni 49, me vendimin nr. 10 të Senatit Akademik me nr. 184 Prot., datë 05.02.2020, Bordi i Administrimit, në mbledhjen e datës 07.02.2020,

V E N D O S I:

1. Të miratojë shfuqizimin e **vendimit nr. 63, datë 14.11.2019**, miratimi i hapjes së programit të dyfishtë të studimit në ciklin e dytë në bashkëpunim me Universitetin e Maçeratës – Itali, "Master i Shkencave" në Arkeologji, Histori dhe Administrim i Pasurive Kulturore – ASPIC dhe shfuqizimin e **vendimit nr. 05, datë 10.01.2020**, miratimi e hapjes i programit të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në Financë – Kontabilitet;
2. Të miratojnë hapjen e programeve të reja të studimit si më poshtë:
 - A. Programin e dyfishtë të studimit të universitetit "Eqrem Çabej" me Universitetin e Maçeratës - Itali, në ciklin e dytë "**Master i Shkencave**" në **Arkeologji, Histori dhe Administrim i Pasurive Kulturore** -- ASPIC, i cili do të realizohet në 2 (dy) vite akademike me 120 ECTS në sistemin me kohë të plotë i cili do të ofrohet nga departamenti i Historisë dhe Gjeografisë në njësinë kryesore të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore;

- B. Programin e studimit të ciklit të dytë **“Master i Shkencave” në Financë – Kontabilitet**, ofruar nga departamenti i Kontabilitet – Financës në njësinë kryesore Ekonomik, i cili do të realizohet me 120 ECTS në 2 (dy) vite akademike;
- C. Programin e studimit të ciklit të dytë **“Master Profesional ” në Shkencat Infermierore**, ofruar nga departamenti i Infermierisë në njësinë kryesore të Shkencave të Natyrës, i cili do të realizohet me 60 ECTS , në 1 (një) vit akademik;
- D. Programin e studimit me karakter profesional 2-vjeçar **“Asistent Menaxher në Mbrojtje Mjedisë”**, ofruar nga departamenti i Biologji – Kimi në njësinë kryesore të Shkencave të Natyrës, i cili do të realizohet me 120 ECTS, në 2 (dy) vite akademike;
- 3 . Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Dr. Merita Isaraj

